



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

DHE MBROJTJES SOCIALE
QËNDRA KOMBËTARE E CILËSISË, SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE

NJOFTIM MBI RUAJTJEN E PRIVATËSISË

PËRMBAJTJA:

1. SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA
2. PERSONAT TË CILËT PËRDORIN SHËRBIMET E QKCSAISH
3. VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT
4. APLIKANTËT PËR PUNË, TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH PUNONJËSIT E QKCSAISH
5. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE
6. LIDHJET ME FAQET E TJERA
7. NDRYSHIMET NË KËTË NJOFTIM MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
8. ANKESA APO PYETJE
9. SI TË NA KONTAKTONI
10. POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

1. SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë tuaj ju tregon se çfarë duhet të prisni kur Autoriteti i Qendrës Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (në vijim QKCSAISH), të mbledhë të dhënat tuaja personale. Kjo vlen për informacionin e mbledhur në lidhje me:

Individët të cilët paraqesin kërkesa të ndryshme për marrje informacioni, dhënie konsulence, etj.

Vizitorët në faqen tonë.

Kandidatët për punësim dhe punonjësit tanë të tanishëm si dhe ish-punonjësit.

2. PERSONAT TË CILËT PËRDORIN SHËRBIMET E QKCSAISH-së

Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore QKCSA-ISH, është struktura në varësi administrative të Ministrisë së Shëndetësisë e krijuar me datë 16/09/2005, me autonomi në veprimtarinë teknike - profesionale lidhur me proceset dhe metodat e përmirësimit të cilësisë, sigurisë, përpilimit si dhe vlerësimit të standardeve dhe nen-standardeve (kriterëve). Mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatimin e strategjise së saj afatgjatë lidhur me përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë të kujdesit shëndetësor, konform eksperiencës dhe praktikës shkencore me pozitive dhe standarteve ndërkombëtare.

Është institucioni i vetëm kombëtar, përgjegjës për kryerjen e akreditimit të institucioneve shëndetësore publike dhe private. Ky proces kryhet bazuar dhe në zbatim të Legjislacionit në fuqi:

- [VKM Nr. 865, date 24.12.2019 "Akreditimi"](#)
- [LIGJ Nr. 27/2019 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 107, DATË 30.3.2009, "PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR](#)
- [LIGJI I KUJDESIT SHËNDETËSOR I NDRYSHUAR, Ligj 51-2013 14.02.2013](#)
- [Ligjin nr. 27, date 8.5.2019, Ligji i Kujdesit Shëndetësor i azhurnuar](#)

3. VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT

Autoriteti i Qendrës Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore disponon faqen zyrtare të institucionit www.qkcsaish.gov.al. Me anë të faqes zyrtare, QKCSAISH transmeton dhe mbledh informacione. Nëpërmjet faqes zyrtare, QKCSAISH u vjen në ndihmë përdoruesve duke ju prezantuar ligjin dhe duke u bërë prezente detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që ata kryejnë si dhe duke njohur subjektet e të dhënave personale me të drejtat e tyre.

Për vizitorët e www.qkcsaish.gov.al sistemi mbledh informacione standarte të cilat kanë të bëjnë me klikimet e artikujve apo rubrikave në këtë faqe.

Sistemi e mbledh këtë informacion në atë mënyrë që të mos identifikojë asnjë vizitor. Ne nuk bëjmë asnjë përpjekje për të gjetur identitetin e vizitorëve që kanë vizituar faqen tonë të internetit.

Autoriteti i QKCSAISH nuk përdorë (dhe nuk lejon ndonjë palë të tretë) mjete statistikore analitike për të ndjekur ose për të mbledhur informacione personale që i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e faqes tonë zyrtare. Ne nuk lidhim asnjë të dhënë të grumbulluar nga kjo faqe me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë, si pjesë e përdorimit tonë.

Faqja zyrtare e internetit të QKCSAISH-së është projektuar bazuar në rregulloren e autoritetit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

4. APLIKANTËT PËR PUNË, TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH PUNONJËSIT E QKCSAISH

Kur persona aplikojnë për t'u punësuar pranë Autoritetit të QKCSAISH, ndjekim procedurat dhe udhëzimet sipas DAP

<http://www.dap.gov.al/> , <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

Për çdo punonjës të QKCSAISH-së, përgatitet dosja përkatëse, e cila ruhet dhe administrohet nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore. Të dhënat e përfshira në të, mbahen të sigurta dhe përdoren vetëm për qëllime që lidhen drejtpërdrejtë me punësimin e personit. Kur marrëdhënia e punës me QKCSAISH-n përfundon, QKCSAISH ruan dosjen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, ligjin për arkivat dhe rregulloren e brendshme të institucionit.

5. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE

Autoriteti i QKCSAISH përpiqet të jetë sa më i hapur për t'i dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale. Individët mund të zbulojnë nëse ne mbajmë ndonjë të dhënë personale, duke na dërguar një “kërkesë për akses tek të dhënat personale” ‘në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëse institucioni mban të dhënat tuaja personale, do të:

- a) Jepet një përshkrim i tyre;
- b) Bëhet me dije se përse ne i mbajmë ato;
- c) Tregohet se te cili marrës mund ti përhapim këto të dhëna;
- d) Jepet një kopje të informacionit në një formë të kuptueshme;
- e) Informohet nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.

Për të bërë një kërkesë pranë QKCSAISH, për çdo të dhënë personale që ne mund të mbajmë, është e nevojshme të bëni një kërkesë më shkrim drejtuar QKCSAISH ose të na e dërgoni në adresën info@qkcsaish.gov.al .

Nëse jeni dakord, ne do të përpiqemi të merremi me kërkesën tuaj në mënyrë jo formale, për shembull duke iu dhënë informacionin specifik nëpërmjet telefonit.

Nëse ne mbajmë informacion në lidhje me ju, ju mund të na kërkonit të korrigjojmë gabimet në të, duke na kontaktuar edhe nje herë.

6. LIDHJET ME FAQET E TJERA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni.

7. NDRYSHIMET NË KËTË NJOFTIM MBI MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ne përditësojmë këtë njoftim në mënyrë të rregullt duke vlerësuar këtë politikë të privatësisë si ndër më të rëndësishmet në veprimtarinë e punës QKCSAISH -së.

8. ANKESA APO PYETJE

QKCSAISH përpiket për të përmbushur standardet më të larta gjatë mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale. Për këtë arsye, institucioni merr shumë seriozisht ankesat në lidhje me këtë temë. Gjithashtu, mirëpresim çdo sugjerim për përmirësimin e procedurave tona.

Ky njoftim mbi mbrojtjen e të dhënave personale u hartua me qëllim për të qenë i qartë dhe i shkurtër. Megjithatë, ne jemi të gatshëm t'ju japim çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm. Çdo kërkesë për këtë duhet të dërgohet në adresën e – mailit info@qkcsaish.gov.al.

9. SI TË NA KONTAKTONI

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në adresën : info@qkcsaish.gov.al.

10. POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Stafi i QKCSAISH-së i nënshtrohet detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit i cili i jepet këtij të fundit për të ushtruar funksionet e tij në bazë Ligjit, dhe mund t'ua përhapë atë vetëm autoriteteve të ligjshme. QKCSAISH ofron udhëzime dhe trajnime stafit të tij për t'u mundësuar atyre të kuptojnë dhe të zbatojnë përgjegjësitë e tyre në respektimin e sigurisë. QKCSAISH vlerëson integritetin e tyre përpara se ata të punësohen. QKCSAISH monitoron pajtueshmërinë e tyre mbi detyrimet e tyre në lidhje me sigurinë.